



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 29 shtator 2020, në mbledhjen e XXIX-të (njëzet e nëntë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari dhe Vendenis Lahu. Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit-DI, Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DSHPMSH, Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, dhe Vezir Januzi, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

I pranishëm në mbledhje ishte edhe z.Rexhep Zeka, përfaqësues i OJQ-së SDK.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera shtoi, besoj që thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, kështu që mund fillojmë me punë në këtë takim, andaj urdhëroni nëse dikush dëshiron fjalën, nëse jo unë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

z.Vendenis Lahu, theksoi, propozoj që në seancën e nesërme të Kuvendit të futet si pikë e rendit të ditës, Informata e Drejtorisë së Arsimit rreth përgatitjeve dhe fillimit të vitit të ri shkollor 2020/2021.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju rikujtoj se propozimi juaj është i vonuar sepse u miratua rendi i ditës, megjithatë rreth këtij propozimi fjalën ia kaloi Drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

z.Agim Blakçori, drejtor i DKA, theksoi, Informata e Drejtorisë së Arsimit rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021, deri më tani nuk është paraparë, por nëse ju dëshironi një informatë të tillë unë mund t'ju sjellë, në mënyrë të detajuar në seancën e radhës të Kuvendit Komunal.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rendi i ditës u miratua dhe evidentuar në procesverbal, në parim ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së jemi pro sjelljes së një informate të tillë por seanca e radhës është ditën e nesërme, unë mendoj që për këtë periudhë kohore nuk mund të përgatitet një informatë në

mënyrë të detajuar. Këtë propozim ne mund ta votojmë dhe të kalojmë si pikë e rendit të ditës mirëpo nëse dëshirojmë informatë në mënyrë të detajuar, mendoj se Grupi i këshilltarëve të LVV-së janë vonuar sepse është dashur para kësaj seance të propozohet kjo pikë e rendit të ditës e jo tani sepse nga të gjitha Grupet e këshilltarëve është krijuar një praktikë që në seanca të japim propozime, aty për aty, kurse rendi i ditës dërgohet 7 ditë pune më herët, ndërsa në mbledhjet e KPF-së është bërë praktikë të bëjmë propozime. Pra dua të them se si Grupe të këshilltarëve apo si shefa të Grupeve, nga cilido subjekt qofshin ata, kur kanë diçka jashtë rendit të ditës kanë 7 ditë pune kohë për të dërguar shkresën zyrtare Kryesuesit të Kuvendit dhe t'i kërkonin që fillimisht ta hedh në votim pikën shtesë të propozuar e pastaj rendin e ditës në tërësi. Secili nga ne këtu nuk mund të përkrahë sjelljen e informatën në fjalë, mirëpo unë personalisht nuk jam i interesuar me marrë informatë jo të detajuar nga drejtori i Drejtorisë përkatëse sepse kam pyetje dhe çështje tjera për të thënë rreth temës në fjalë e që të paktën në aspektin moral Drejtoria përkatëse duhet të jap përgjigje, nëse ka nëse jo atëherë përgjigjet na jepen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, kështu që edhe nëse votojmë apo abstenojmë është keq sepse edhe po të votojmë për, që të sjellët informatë e pa plotësuar unë nuk jam i interesuar.

Drejtori i DKA-së e dha përgjigjen, është mirë që ju zotëri Lahu të merrni qëndrim rreth kësaj e jo të mbeten me 2 vota, ngase nuk jam i interesuar as unë që në këtë proces të votimit t'ju lë me 2 vota. E them këtë sepse kur ka arsyeshmëri unë ju kërkoj votën juve si LVV, por për rastin konkret që ju shprehët interesim për një informatë të tillë për seancën e radhës (që është nesër), përkatësisht që drejtori i DKA-së të raportoi, nuk e shohë të arsyeshme, sepse konsideroj se do të ishte mirë që informata të përgatitet në mënyrë të detajuar, pra nëse ju si Grup i LVV-së e shihni të arsyeshme, vendosni vet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, jua rikujtoj parafolësve se sipas Rregullores së punës së kuvendit, në rend të ditës nuk ka debat, andaj lus që të t'i përmbahemi procedurave dhe rregullave të Kuvendit.

z.Vendenis Lahu, theksoi, unë vetëm desha të bëjë një propozim i nderuar z.Rafet Llapashtica, është e kuptueshme ajo që e cekët ju dhe një gjë ë tillë e kemi parasysh. KPF i paraprin mbledhjes së kuvendit dhe mund të propozoj dhe mbështesë edhe pika të reja të rendit të ditës për seancat e radhës apo të heq ndonjëren prej atyre. Në këtë rast ne mbledhjen e KPF-së po e mbajmë 1 ditë para seancës së Kuvendit e që ka mundësi që këto mbledhje të KPF-së të mbahen 2 ose më shumë ditë më herët e që do të kishim mundësi të propozojmë pika të reja, mirëpo ne sot po e mbajmë këtë mbledhje dhe në bazë të rrethanave mua më duhet të veproj.

Sa i përket asaj që drejtori i DKA-së e potencoj lidhur me sjelljen e një informate të tillë, por jo të detajuar, mendoj se një informatë të tillë mund të na sjellët edhe pas një muaji. Realisht kjo pikë e rendit të ditës ka qenë edhe kërkesë edhe në muajin e kaluar e këshilltarit dhe anëtarit të KPF-së e z.Patriot Rudari mirëpo kjo kërkesë është shtyrë dhe ne e dimë që drejtori i DKA-së e ka për detyrë të raportoj për gjendjen në arsim dhe për këtë është i gatshëm të na informojë ose të paktën mendoj se një informatë të tillë duhet ta ketë të gatshme sepse për çdo fillim të viti të ri shkollor jemi në dijeni se ka detyra të caktuara të cilat duhet të përmbushen. Sa për informatë është në domenin e drejtorit se çfarë do të flasë nesër apo pas një muaji sepse ne nuk mundemi me ia përcaktuar atij se çfarë do të deklaroj por mund të përcaktojmë se çfarë do të kërkojmë ne, por është shumë e rëndësishme që të diskutohet sa më shpejt të jetë e mundur rreth gjendjes në arsimin e Komunës së Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar Kryesues kërkoj falje edhe një herë sepse po bastardohet debati paksa, e them këtë sepse kur një këshilltar vije në seancë përgatitet për debat në bazë të materialeve andaj nëse unë kam pasë diçka për rend të ditës është dashur t'ju dërgoj shkresë më herët sepse është e kotë t'i deklaroj cilit do drejtor kur nuk jam i përgatitur dhe nuk kam material, nëse seancat i mbajmë vetëm sa për të thënë diçka secili nga ne si Grupe të këshilltarëve dhe të japim deklarata politike është një çështje krejt tjetër, mirëpo përgatitjet për seancë duhet bëhen me materiale.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, konsideroj se u sqaruam rreth kësaj çështje, megjithatë edhe pse u votua paraprakisht rendi i ditës, unë po e hedh në votim propozimin e këshilltarit z.Vendenis Lahu për futjen e një pike shtesë në kudarë të rendit të ditës, përkatësisht informatë nga Drejtoria e Arsimit rreth përgatitjeve dhe fillimit të vitit të ri shkollor 2020/2021.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 2 vota për, 4 vota kundër dhe 3 vota të përmbajtura, nuk kalon propozimi i z.Vendenis Lahu, për përfshirje në rend të ditës në mbledhjen e Kuvendit të caktuar për datën 30 shtator 2020, pikën Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth përgatitjeve dhe fillimit të vitit të ri shkollor 2020/2021.

2. Propozim Vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, të nderuar, para vetës kemi për diskutim projektbuxhetin e Komunës për vitin 2021 dhe projeksionet buxhetore për vitet 2022/2023, sigurisht jeni në dijeni se ky vit është jo i zakonshëm dhe që na ka përcjellë me probleme dhe vështirësi në të gjitha aspektet e jetësore, po ashtu edhe në sferën e planifikimit buxhetor. Procesi buxhetor zakonisht fillon në mesin e muajit maj, gjegjësisht me vënien në qarkullim të Qarkores Buxhetore 2021/01 në këtë rast, dokument në bazë të të cilit është përgatitur Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB-2021-2023 e Komunës së Podujevës dhe e cila është miratuar nga Kuvendi i Komunës në fund të qershorit të këtij viti, pra ky është dokumenti burimor në bazë të cilit ne e kemi përgatitur projektbuxhetin e Komunës për vitin 2021.

Më 10.08.2020 nga Ministria e Financave është lëshuar Qarkorja Buxhetore 2021/02 sipas të cilës janë përcaktuar kufijtë buxhetor për vitin 2021/2023, përfshirë edhe kufijtë nëpër kategori dhe programe përkatëse ekonomike, dhe duke marrë pasë parasysh vështirësitë që i ceka në fillim, sërish më 26.08.2020 Ministria e Financave njofton të gjitha Organizatat Buxhetore se është e nevojshme që të ndryshohet në nivel vendi Korniza Afatmesme e Shpenzimeve-KASH për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 e cila ka sjellë vështirësi në të gjitha aspektet, andaj edhe është dashur domosdoshmërisht që të ndryshohet KASH e cila ishte miratuar në muajin mars nga ana e Qeverisë.

Si rezultat i kësaj, të gjitha Organizatat Buxhetore kanë qenë të obliguara që të presin Qarkoren Buxhetore 2021/03, në mënyrë që të përgatitet projektbuxheti për vitin 2021/2023, si pasojë e saj është ndërruar KASH dhe me datën 14.09.2020 të gjitha Organizatave Buxhetore iu dërgohet Qarkorja Buxhetore 2021/03 sipas të cilës përcaktohen kufijtë final për vitet 2021/2023. Pra kjo është ajo që disa herë e ceka se ky vit na ka përcjellë vazhdimisht me vështirësi, konkretisht për shkak se më 14.09.2020, lëshohet Qarkorja Buxhetore 2021/03, ndërsa sipas Ligjit përkatës, deri më 01.09.2020 është dashur që propozim projektbuxhetet komunale të jenë të përgatitura/gatshme dhe të lëshohet në diskutim publik gjë e cila nuk ka ndodh brenda kësaj periudhe kohore sepse nga data 14.09.2020 deri ditën kur është dërguar materiali te ju është dashur të punohet në mënyrë intensive dhe të përshtaten kufijtë buxhetor për kategori ekonomike dhe të përshtaten edhe projektet të cilat kanë qenë të miratuara në KAB sepse është dashur t'i përmbahemi dokumenteve të leshura nga Ministria e Financave më datën 14.09.2020.

E shohë të arsyeshme t'i lexojë ndryshimet që kanë ndodhë për dallim nga dokumentit të miratuar i KAB 2021/23 në muajin qershor dhe dokumentit përkatësisht propozim projektbuxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe projeksionet 2022/2023 të cilin e kemi para vetës për shqyrtim dhe miratim.

Derisa në KAB kemi pasë një buxhet të miratuar në shumë prej 23,181,801.00€, dhe atë me planifikim sipas Ekzekutivit të Komunës ka qenë, si vijon; -paga dhe mëditje 13,001,512.00€, -mallra dhe

shërbime 2,433,578.00€, -kapitale 420,000.00€, -subvencione 700,50.00€ dhe investime kapitale 6,626,661.00€. Në periudhën e parë është miratuar KAB në bazë të Qarkores Buxhetore 2021/01, nuk kemi pasë kufizime nëpër kategoritë ekonomike dhe planifikimi është bërë i pavarur si buxhet total duke i respektuar gjithmonë grandet specifike, atë të arsimit dhe shëndetësisë, kategori të cilat kemi të drejtë t'i risim në programe të caktuara por nuk kemi të drejtë të marrim fonde nga këto kategori dhe programe dhe t'i destinojmë programet tjera.

Qarkorja buxhetore 2021/03 përmban një buxhet prej 23,853,654.00€, ashtu siç e keni në vendim por në këtë dokument në bazë të kësaj Qarkoreje është fut edhe Klauzole e Investimeve që është 1,125,298.00€, e cila përmban projektin për kolektorin e ujërave të zeza në Komunën e Podujevës, e që më parë nuk ka qenë praktikë. Sipas kufijve final të Ministrisë së Financave me Qrkoren Buxhetore 2021/03, kategoria e pagave dhe mëditjeve për vitin 2021 është 12,550,000.00€, mallra dhe shërbime 2,533,578.00€, komunal 420,000.00€, subvencione 750,050.00€, kapitale 6,474,728.00€ dhe Klauzola e Investimeve që i bashkohet kategorisë së kapitaleve 1,125,298.00€. Nëse e kalkulojmë ndryshimin mes KAB dhe këtij projektbuxheti del se buxheti është rritur 671,853.00€, këtë ndryshim e bënë Klauzola e Investimeve, dhe nëse e heqim këtë Klauzolë atëherë kemi zvogëlim për 451,445.00€, por si do që të jetë Klauzola e Investimeve është një fond burimor që investimet kapitale të Komunës së Podujevës financohen nga ai fond burimor -06, që është kredi e Bankës së Austrisë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, realisht nëse nuk kemi çfarë të propozojmë, sugjerojmë apo të kërkojmë plotësim ndryshim ne sot atëherë as debat nuk kemi nevojë të bëjmë rreth kësaj pike ngase si pikë ne morëm vendim që të rekomandohet për Kuvend, pavarësisht që edhe nëse sot nuk debatojmë e kemi mundësinë të debatojmë në mbledhjen e Kuvendit, prandaj nuk e shohë të arsyeshme ta debatojmë më gjatë në KPF pasi që në këtë Komitet nuk mund të marrim vendime por vetëm mund rekomandojmë e që mund të jetë i vetmi përfundim si rekomandim për Kuvend, kështu që mos t'i zgjasim procedurat më shumë sepse edhe ashtu është obligim ligjor që projektbuxheti si përfundim të shqyrtohet në Kuvend, prandaj ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për ditën e nesërme. Madje konsideroj që edhe në mbledhjet tjera të KPF-së të mos i zgjatim debatet e panevojshme eventuale rreth pikave të rendit të ditës, natyrisht nëse këshilltarët tjerë dhe Grupet tjera të këshilltarëve nuk kanë pika shtesë, kërkesa të ndryshme etj të ngjashme, e them këtë sepse në fakt rendi i ditës po miratohet andaj për çfarë mund të debatojmë më pastaj, kurse për pyetje dhe kërkesa për llogaridhënie drejtorëve iu kërkojmë në seancat e Kuvendit sepse është organ që merr vendime, jo KPF-ja, madje edhe nëse të gjithë këtu dalim kundër propozim projektbuxhetit ne vetëm mund ta ndalim të mos shkoj në Kuvend për shqyrtim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që kush është që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim propozim vendimi për projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2022/2023.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2022/2023, sipas materialit përkatës të proceduar me thirrjen e mbledhjes së KPF-së për datën 29.09.2020, respektivisht thirrjes së mbledhjes së Kuvendit të Komunës për datën 30.09.2020.

3. Propozimi Vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë-38

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, sigurisht të gjithë jeni të njoftuar se gjatë vitit 2020 ka qenë i paraparë të hynë në fuqi dhe të filloj implementimi i Ligjit të ri për paga, ndërkohë Gjykata Kushtetuese ka hedhë poshtë këtë ligj dhe si rrjedhojë nuk ka mund të implementohet e që si rezultat i këtij ligji të gjitha Organizatat Buxhetore kanë planifikuar edhe buxhet për implementimin e tij, konkretisht në kategorinë e pagave dhe mëditjeve gjë të cilën edhe e kemi planifikuar, mirëpo të gjithë jemi dëshmitarë rreth asaj se çfarë ka ndodh me këto mjete të planifikuara për kategoritë e pagave dhe mëditjeve ku Ministria e Financave me një vendim të Ministrit në konsultim me Kryetarët e Komunave e ka vendos në një rezervë dhe ka vënë kodin nr.38, planifikime të cilat janë mbajtur gjatë tërë vitit duke pritur të aplikohet Ligji i cekur në mënyrë që të kemi mjete të mjaftueshme buxhetore, por meqë ashtu siç e theksova aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Ligji është kthyer mbrapsht atëherë Komunave iu është sugjeruar që këto mjete të mund t'i përdorin për nevojat e tyre varësisht nga kërkesat që rrjedhin nga programet gjegjësisht nga Drejtoritë duke përjashtuar kategoritë e pagave dhe mëditjeve.

Këto mjete kanë qenë të planifikuara për paga dhe mëditje por nuk mund të shfrytëzohen dhe transferohen prapë në këtë kategori për shkak se planifikimi i rregullt mjafton që deri në fund të vitit me këto mjete të përfundoj viti. Në bazë të këtyre sqarimeve të Ministrisë së Financave, me një vendim të Kuvendeve Komunale dhe me miratim të Ministrit të Ministrisë së Financave këto mjete mund të jenë në dispozicion të Organizatave Buxhetore, në këtë rast Komunës së Podujevës sipas kërkesave të Drejtorive. Ky ka qenë një sqarim i Ministrisë së Financave që planifikimi buxhetor të bëhet komfor programeve duke ruajtur mjetet të cilat kanë qenë të planifikuara në Drejtorinë e Arsimit dhe në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në mënyrë që mjetet e planifikuara për këto dy kategori të jenë të mbrojtura dhe të shfrytëzohen vetëm në këto dy programe, ndërsa mjetet që kanë qenë të planifikuara në programe tjera dhe në Administratën Komunale ato mund të jenë në funksion të programeve ku Ekzekutivi i Komunës e sheh më të arsyeshme, andaj propozimet që kanë rrjedhë janë në bazë të kërkesave por gjithherë duke mbrojtur mjetet nga grandit specifik i arsimit dhe shëndetësisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendi për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë-38 sipas materialit përkatës të proceduar me thirrjen e mbledhjes së KPF-së për datën 29.09.2020, respektivisht thirrjes së mbledhjes së Kuvendit të Komunës për datën 30.09.2020.

Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0058820/20

Podujevë,

29 shtator 2020

Kryesuesi i Komitetit

Fatmir Gashi